


Për:	Operatorin Ekonomik: N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ" me adresë në Graçanicë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, U.D. Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	07.10.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 03.10.2019, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ" me adresë në Graçanicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV**, Numri i Prokurimit: **623-19-6024-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-19-052-5-2-1**, **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV – Loto I**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ" me adresë në Graçanicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV**, Numri i Prokurimit: **623-19-6024-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-19-052-5-2-1**, **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV – Loto I**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 30.09.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autorteti Kontraktues vendos të vazhdoj Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV**, Numri i Prokurimit: **623-19-6024-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-19-052-5-2-1**, **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV – Loto I**, dhe mbështetë Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik: N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ" me adresë në Graçanicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV**, Numri i Prokurimit: 623-19-6024-5-2-1, Nr. i brendshëm: 623-19-052-5-2-1, KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV – Loto I, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 30.09.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 03.10.2019, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

Pretendimi 1:

- Në ofertën e dorëzuar nga Grupi i OE çmimi i ofruar është llogaritur me TVSH edhe pse drunjët dekorativ janë të liruar nga TVSH sipas ligjit Nr. 05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar Neni 29.

Përgjigje nga A.K: Ky fakt nuk qëndron, pasi që te Procesverbali i hapjes së ofertave ka qenë i njëjtte me ofertën e dorëzuar te përshkrimi i çmimeve.

Ndërsa sa i përket pretendimit tuaj për gabimet me TVSh, sipas KRPP – së tek Pyetjet e Shpeshta thotë:

46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë

Ndera sa i përket ligjit nr. 05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar, neni 29, paragrafi 2 thotë:

2. Importi i mallrave të listuara në Shtojcën IV të këtij ligji thotë:

Drunj të gjallë dhe bimë të tjera: bulba, rrënjë dhe të ngjashme, ashtu siç janë përshkruar në titujt e shënuar në kolonën vijuese.	0601 dhe 0602
Patate, farë	0701 1000
Qepë, tuba	0703 1011

Andaj si Pretendim i juaj është i paqëndrueshëm, edhe pse te argumentet e lartcekura themi që drunjë dekorativ nuk janë të liruar nga TVSh – ja, ju si O.E. keni vepruar ne kundërshtim me Përshkrimin e çmimeve, edhe nëse “*drunjë dekorativë janë të liruar nga TVSh – ja*” atëherë kemi pozicione tjera te Përshkrimi i çmimeve siç janë: *Vazo në formë të gjysmë fuqisë së Verës*, që nuk janë të liruar nga TVSh – ja.

Pretendimi 2:

- Në dokumentacionin e shqyrtuar është vërejtur se siguria e tenderit për dosjen e tenderit nuk është bërë në emër të grupin të OE, por vetëm në emër të OE N.T.P. FIDANISHTJA “GJELBËRIMI”.

Përgjigje nga A.K: Ky fakt nuk qëndron, pasi që Sigurimi i tenderit është bërë nga Lideri i konzerciumit: N.T.P. Fidanishtja “Gjelbërimi”, dhe është dorëzuar vetëm një (1) Polis e Sigurimit, ku te programi i Kompanive te sigurimit për të bërë një Polis te Sigurimeve duhet te behet me nr. te regjistrimit te biznesi, dhe nuk mund te vendosin dy (2) nr. te regjistrimit për një polis, ku vlera e sigurisë së tenderit: **5,000.00 Euro**, sipas kërkesës në Dosjen e tenderit, dhe Lideri i konzerciumit e përfaqëson Sigurimin e tenderit, andaj si Pretendim është i paqëndrueshëm.

Pretendimi 3:

- Në rastin e krijimit të grupit të OE N.T.P. FIDANISHTJA “GJELBËRIMI” & N.T.P. “Las Pallmas” deklarata për autorizimin e partnerit kryesor nuk është nënshkruar nga të dy antarët e grupit, e cila kërkohet në FDT të dosjes së tenderit.

Përgjigje nga A.K: Ky fakt nuk qëndron, pasi që sipas Dosjes se tenderit: Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD), Neni 11.1 Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik, pika c. thotë: *një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit.*

Këtu kemi vetëm një anëtarë të grupit i cili është: N.T.P. "Las Pallmas", i cili e autorizon partnerin kryesor: N.T.P. Fidanishtja "Gjelbërimi" për të vepruar në emër të grupit, ku partneri kryesor është: N.T.P. Fidanishtja "Gjelbërimi", dhe sipas Dosjes se tenderit dhe Ligjit të Prokurimit Publik, partneri kryesor i ndalohet të nënshkruar te autorizimi sipas LPP – së.

Pretendimi 4:

- Në lidhje me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 2 si dëshmi është kërkuar një deklaratë për caktimin e menaxherit të projektit i cili duhet të jetë një Agronom i Diplomuar, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit. Një deklaratë e tillë nuk është prezantuar nga ana e grupit të OE fitues, por vetëm një deklaratë që e cakton Z. Qamil Krasniqin si Agronom për këtë projekt.

Përgjigje nga A.K: Ky fakt nuk qëndron, pasi që sipas Dosjes se tenderit: Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD), Neni. 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, tek Dëshmia 2 thotë: • **Një deklaratë me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për – Loto 2.**

Pra sipas Dosjes se tenderit: Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD), për Loto 1 nuk është kërkuar asnjë deklaratë me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit, andaj ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Pretendimi 5:

- Në listën e stafit profesional të dorëzuar nga anëtari i grupit OE N.T.P. FIDANISHTJA "GJELBËRIMI" përvoja e punës së agronomit është shënuar se është 22 vjet, por në kontratën për këtë projekt në mes të OE dhe Z. Qamil Krasniqi ceket se përvoja e punës është 25 vjet, mospërputhje në përvojën e punës së tij është e cekur dhe në CV ku është shënuar së Z. Qamil Krasniqi ka përvojë punë 4 vjeçare në kompaninë "EBE" SHPK. Ky fakt e bën të dyshimtë se të gjitha kontratat e dorëzuara nuk janë të vërteta, poashtu ato janë të nënshkruara me datë 01.01.2019 datë kjo e cila është festë zyrtare në Republikën e Kosovës.

Përgjigje nga A.K: Ky fakt nuk qëndron, pasi që sipas Dosjes se tenderit: Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD), Neni. 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, tek Kërkesa 2 thotë: **Një Agronom të Diplomuar, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit – Loto 1.**

Dëshmia 2:

- **Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar:** Data e diplomimit: 09.02.1989.
 - **CV-në (origjinal + të nënshkruar nga vetë pala):** Përvojë e punës: 03.01.2014 – 25.12.2018.
 - **Kontrata valide e punës për stafin profesional – Kopje:** Kontratë pune për një projekt (në vepër), e nënshkruar me datë: 27.08.2019, e jo me datë: 01.01.2019, sipas pretendimit tuaj.
- Ndërsa Dëshmia 1: Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, minimum. 10 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik.

Sipas Dosjes se tenderit: Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD), nuk është kërkuar nga O.E. të dorëzoj dhe kontrata për punëtor, ku ju si O.E. Ankues keni vërejtur disa kontrata me punëtor të nënshkruar me datë: 01.01.2019.

Pra ky pretendim i juaj është i paqëndrueshëm.

Pretendimi 6:

- Me rastin e formimit të një grupi OE N.T.P. FIDANISHTJA "GJELBËRIMI" & N.T.P. "Las Pallmas" kanë nënshkruar një marrëveshje konzorcioni ku partneri kryesor (udhëheqësi i konzorciumit) do të jetë N.T.P. FIDANISHTJA "GJELBËRIMI" me pjesëmarrje 60% në këtë projekt. Në bazë të kësaj marrëveshje nënkuptohet se OE N.T.P. FIDANISHTJA "GJELBËRIMI" duhet të i prezentoj 60% të dokumentacionit të kërkuar në dosjen e tenderit. Tek projektet e realizuara në tri vitet e fundit OE N.T.P. FIDANISHTJA "GJELBËRIMI" ka prezentuar referenca për vetëm 79,812.55 €, pra nuk është arritur 60% e vlerës së kërkuar prej 370,000.00 €. E njëjta vlerë nuk është valide pasi kontrata e njëjtë është e përfshirë në listën e kontratave të prezentuara nga anëtar i grupit OE N.T.P. "Las Pallmas". Poashtu tek lista e dorëzuar nga OE N.T.P. "Las Pallmas" janë dorëzuar projekte me të vjetra se 3 vitet e fundit dhe kontratat të cilat ende nuk janë përfunduar (kontrata me numër rendor 4 prej 19.10.2016 - 19.10.2019), kurse në FDT kërkohen vetëm projektet për 3 vitet e fundit nga data e njoftimit të kontratës.

Përgjigje nga A.K: Ky fakt nuk qëndron, pasi që sipas: **Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, neni 27. Grup i Operatorëve Ekonomik – 27.4 Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e operatorëve ekonomikë duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-se. Kjo do të thotë se AK-se mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave nga njeri anëtar i grupit të OE.**

Andaj ne si A.K. nuk kemi vendosur asnjë përqindje minimale për kritere sipas nenit 68 dhe 69 të LPP – së, se sa duhet të përmbush lideri apo anëtar i konzerciumit, ndërsa të marrëveshja e konzerciumit, Grup i operatorëve ekonomik këtë marrëveshje e kanë bërë për realizim të projektit, e jo kritereve.

Anëtar i konzerciumit: N.T.P. "Las Pallmas" tek Kapaciteti teknik dhe profesional, kërkesa 3. Këtë kriter e ka plotësuar në tërësi të plotë, pasi që kërkesa e A.K. ka qenë: **DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca/t ose Pranimit teknik për punë të kryera në lëmin e punëve të ngjashme**, pra ka dorëzuar referenca që e plotësojnë në tërësi këtë kriter.

Pretendimi 7:

- Në listën e mjeteve të dorëzuara nga grupi i OE mungojnë dy kamion, pasi që kamionët e dorëzuar në dosje janë në emër të pronarit z. Sefedin Berisha e jo të kompanisë si dhe nuk përmbajnë marrëveshje për shfrytëzim për këtë projekt apo për një kohë të caktuar. Pra nuk është përmbushur kërkesa nr.4 në lidhje me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të dosjes së tenderit.

Përgjigje nga A.K: Ky fakt nuk qëndron, pasi që të Lista origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik e pajisjeve – mjeteve të punës në dispozicion për realizimin e punimeve, janë në emër të Operatori Ekonomik, kurse të Kërkesa nr. 4:

Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit

- Dy (2) Kamion,

- Një (1) Bager 1.5 tonë për Lot 1.

A.K. Komuna e Rahovecit, nuk ka cekur se këto pajisje duhet të jenë në emër të Operatori Ekonomik apo pronarit, por është cekur: *Lista e makinerisë dhe mjeteve të punës që janë përshkruar të kërkesa numër 4. të nevojshme për realizimin e punëve të dokumentohen me dokumentacion të pronësisë ose të kontraktuar me marrëveshje origjinale për shfrytëzim.*

Pra ky pretendim i juaj është i paqëndrueshëm.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
U.d. Menaxher i Zyres së Prokurimit
Komuna e Rahovecit